

VENDIM
Nr.842, datë 6.12.2011

**PËR MIRATIMIN E VLERËS SË KOMPENSIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA
NË KULTURAT BUJQËSORE E NË BIZNESE, NGA RESHJET E SHIUT DHE
PËRMBYTJET, NË QARKUN E SHKODRËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 295, datë 5.4.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun Shkodër, në shumën 1 112 303 342 (një miliard e njëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e tre mijë e treqind dyzet e dy) lekë.

2. Miratimin e listave të familjeve dhe subjekteve të biznesit të qarkut të Shkodrës, së bashku me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kulturat bujqësore dhe në biznese, sipas listave të njësive të qeverisjes vendore, si më poshtë:

a) Lista e familjeve të qarkut të Shkodrës, me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kultura bujqësore, për bashkinë Shkodër; komunat Bushat, Dajç, Velipojë, Bërdicë, Ana e Malit, Rrethina, Qendër Koplik, Gur i Zi, Kastrat, Gruemirë dhe të tjera, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Lista e subjekteve të biznesit të qarkut të Shkodrës, me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në biznese, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. *Diferenca e palikuiduar nga vlera e kompensimit, prej 1 112 303 342 (një miliard e njëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e tre mijë e treqind dyzet e dy) lekësh, që do të rezultojë pas rakordimit të shumave të paekzekutuara ndaj familjeve dhe subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, të paguhet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH, sh.a.)*

Për këtë qëllim, KESH, sh.a.-ja., të realizojë rakordimin e shumave të mbetura të paekzekutuara ndaj familjeve dhe subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi. Rakordimi i detyrimit të mbetur pa u ekzekutuar të bëhet nga KESH, sh.a.-ja., bazuar në:

- *të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme për listën e plotë të familjeve dhe subjekteve të cilat përfitojnë kompensim, në të cilën duhet të evidentohen vlerat fillestare, vlerat e shlyera dhe vlerat e mbetura të detyrimit;*

- *të dhënat e shoqërisë OSHEE, sh.a., për listën e plotë të familjeve dhe subjekteve të dëmtuara, për të cilat, në zbatim të parashikimeve të vendimit nr.482, datë 6.5.2015, të Këshillit të Ministrave, janë shuar detyrimet e energjisë elektrike që kishin ndaj OSHEE, sh.a.-së, me të drejtën për kompensim, përfutur sipas parashikimeve të vendimit nr.842, datë 6.12.2011, të Këshillit të Ministrave.*

Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe OSHEE, sh.a.-ja, të sigurojnë të dhënat e përcaktuara në pikën 3, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. KESH, sh.a.-ja., pasi të rakordojë detyrimet e pashlyera, të fillojë menjëherë kryerjen e drejtpërdrejtë të pagesave ndaj subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, të cilave nuk u është përmbytur detyrimi i dhënies së kompensimit për dëmet në kulturat bujqësore dhe në biznese.

Kryerja e pagesave të bëhet drejtpërdrejt nga KESH, sh.a-ja., nëpërmjet bankave të nivelit të dytë, me të cilat KESH, sh.a-ja., do të bashkëpunojë për dhënien e këtij shërbimi. Procedurat e pagesës përcaktohen me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

KESH, sh.a-ja., ngarkohet të informojë, me shkrim, pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Prefektit të Qarkut Shkodër në përfundim të procesit.

5. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Punëve të Brendshme, KESH, sh.a-ja., dhe OSHEE, sh.a-ja., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha